



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:166923
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05783912

K.DH.Shk II.nr. 874/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “Fabrika e Veglave Plus AE” SH.P.K., me NUI:810516792, me seli në Ferizaj, rruga “Besim Rexhepi” p.n, përfaqësuar nga K.Z., kundër debitorit “Trepça” SH.A., me NUI:811278747, me seli në Mitrovicë, Parku Industrial, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1176/23 të datës 30.11.2023, me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1176/23 të datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1176/23 të datës 30.11.2023, ka Refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.A., me seli në Mitrovicë ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 319/22, i lejuar me datë 07.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Mubarak S Shumolli, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 319/22, i lejuar me datë 07.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Mubarak S Shumolli, mbetet ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1176/23 të datës 30.11.2023.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë,

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Fabrika e Veglave Plus AE” SH.P.K., me dt. 07.10.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Nr. 21-SHV01- 001-350 të datës 11.10.2021, Faturës Nr. 21-SHV01-001-355 të datës 15.10.2021, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,760.00 €, me kamat ligjore 8%, ashtu që të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, deri në pagesën e shumës së kërkuar për përmbartim dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi, si dhe shpenzimet e procedurës. Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke theksuar ndër të tjerash se e kundërshton në tërësi urdhrin përmbartimor pasi që propozimi për përmbartim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm. Gjykatës i ka propozuar që ta hedhë poshtë urdhrin për përmbartim

Po ashtu kreditori me përgjigje në prapësim ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pabazuar prapësimin e parashtruar nga debitori. Tutje ka shtuar se pretendimet e debitorit se dokumenti i besueshëm nuk është dorëzuar në origjinal, nuk qëndrojnë për faktin se kreditori propozimit për përmbartim i’a ka bashkangjitur faturat në origjinal, dhe të njëjtat gjenden në shkresat e lëndës P.nr.319/2022. Tutje ka shtuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për iniciimin e

procedurës përmbarimore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pathemeltë prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë duke vendosur lidhur me pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim: Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se Faturën Nr. 21-SHV01-001-350 të datës 11.10.2021 dhe Faturën Nr. 21-SHV01-001-355 të datës 15.10.2021, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Po ashtu kjo gjykatë ka gjetur se Fatura Nr. 21-SHV01-001-350 e datës 11.10.2021, dhe Fatura Nr. 21-SHV01-001-355 e datës 15.10.2021, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit, si dhe të njëjtat nuk janë kontestuar nga debitori.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës se parashtruar ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt kur ka hedhur prapësimin e debitorit të përmbarimit.

Andaj bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të debitorit lidhur me pretendimin e tij se propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit të besueshëm dhe se ashtu siç ka deklaruar në ankesë debitori kundër urdhrit përmbarimor P.nr. 319/22, i lejuar me datë 07.10.2022.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar.

Më te drejt gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K. DH.Shk II.nr. 874/24 me datë 05.06.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti